Nr. Ref. BD-181/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Procesverbalet e mbledhjeve të datës 27 prill 2023 dhe asaj të jashtëzakonshme datë 17 maj 2023 nëpërmjet kësaj aprovohen si procesverbale të mbledhjes së Bordit të cekura më lartë.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi sipas procedurave procesverbalet e mbledhjeve paraprake të mbajtur me datë 27 prill 2023 dhe asaj të jashtëzakonshme datë 17 maj 2023. Dokumentet aprovohen në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska Agencija za Privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo
ZQ / HQ / QS - Prishtinë - Priština

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/2

Në bazë të neneve 6A dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Vendimit përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësim me nr. 20/67 të datës 09 mars 2022, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet transferimi i pronës me detajet e pronës: Prona e paluajtshme parcelat nr. 311-0 dhe nr. 312-0 ZK Pejë e NSH Jugopetrol, Pejë, në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për ndërtimin e Objektit të ri të Gjykatës themelore në Pejë në përputhje me Vendimin Përfundimtar për Shpronësim nr. 20/67, të datës 09.03.2022.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e kërkesës për transfer të pronës shoqërore sipas kërkesës së KGJK-së për nevoja të Gjykatës Themelore në Pejë për interes publik sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vemdimi.

Më datë 09 mars 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin Përfundimtar me nr. 20/67 përmes së cilit është miratuar shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme me interes publik në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së) për ndërtimin e Objektit të ri të Gjykatës themelore në Pejë, konkretisht pronat e paluajtshme parcelat nr.311-0 me sipërfaqe prej 3,046 m2 dhe nr.312-0 ZK me sipërfaqe prej 598 m2, ZK Pejë e NSH Jugopetrol, Pejë. Pas Vendimit Përfundimtar të Qeverisë me nr. 20/67 të datës 09 mars 2022 si dhe zbatimit të të gjitha procedurave ligjore të këtij shpronësimi, me datë 29.04.2022 AKP ka percjellur shkresën nëpërmjet së cilës janë paraqitur të dhënat e llogarisë bankare, shumat aktuale për pagesë. Më datë 04.05.2023 nga KGJK është pranuar dëshmia e pagesës 20% të shumës totale të shpronësimit, në emër të shpronësimit për pronat e paluajtshme parcelat nr. 311-0 dhe nr. 312-0 ZK Pejë e NSH Jugopetrol, Pejë dhe që titulli pronësor të kaloj në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së). Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka dërguar në AKP letër zotimin (për mjetet eventuale shtesë të pagesës) para se të merr vendim Bordi i Drejtorëve për lejimin e bartjes së pronësisë.
Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/3

Në bazë të neneve 6A të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Vendimit përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpronësim me nr. 10/132 të datës 08 mars 2022, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet transferimi i pronave të NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019), Podujevë me detajet e pronës: Prona e paluajtshme nr.81-0, nr.89-0, nr.90-0, nr.187-0, nr.190-0, nr.192-0, nr.193-0, nr.510-0, nr.198-0, nr.199-0, nr.219-0, nr.220-0, nr.221-0, nr.222-0, nr.223-1, nr.224-1, nr.225-0, nr.226-1, nr.241-0, nr.509-0, nr.245-0, nr.266-0, nr.267-0 dhe nr.292-0 ZK Livadicë Komuna e Podujevës për realizimin e projektit: Ndërtimi i "Zonës Ekonomike Industriale",në emër të Komunës së Podujevës në përputhje me Vendimin Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Shpronësim nr. 10/132, të datës 08.03.2023.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e kërkesës për transfer të pronës shoqërore sipas kërkesës së Komunës së Podujevës për interes publik sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vemdimi.

Më datë 08 mars 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin Përfundimtar me nr. 10/132 përmes së cilit është miratuar shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019), Podujevë,nr.81-0, nr.89-0, nr.90-0, nr.187-0, nr.190-0, nr.192-0, nr.193-0, nr.510-0, nr.198-0, nr.199-0, nr.219-0, nr.220-0, nr.221-0, nr.222-0, nr.223-1, nr.224-1, nr.225-0, nr.226-1, nr.241-0, nr.509-0, nr.245-0, nr.266-0, nr.267-0 dhe nr.292-0 ZK Livadicë Komuna e Podujevës me sipërfaqe prej 279,798.41m2 për realizimin e projektit: Ndërtimi i "Zonës Ekonomike Industriale",në emër të Komunës së Podujevës. Pas Vendimit Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.10/132 të datës 08 mars 2023 si dhe zbatimit të gjitha procedurave ligjore të këtij shpronësimi, më datë 29 mars 2023 nga Komuna e Podujevës është pranuar dëshmia e pagesës së 20% të kështit shumës totale të shpronësimit EUR 250,000.00, në emër të shpronësimit për pronat e paluajtshme nr.81-0, nr.89-0, nr.90-0, nr.187-0, nr.190-0, nr.192-0, nr.193-0, nr.510-0, nr.198-0, nr.199-0, nr.219-0, nr.220-0, nr.221-0, nr.222-0, nr.223-1, nr.224-1, nr.225-0, nr.226-1, nr.241-0, nr.509-0, nr.245-0, nr.266-0, nr.267-0 dhe nr.292-0 ZK Livadicë Komuna e Podujevës të NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019), Podujevë dhe që titulli pronësor të kaloj në emër të Komunës së Podujevës. Komuna e Podujevës pas nënshkrimit të marrëveshjes me AKP ka dërguar në AKP letër zotimin (për mjetet eventuale shtesë të pagesës) para se të merr vendim Bordi i Drejtorëve për lejimin e bartjes së pronësisë.Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/4

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 353 m2, pjesë e parcelës nr. 292-1, me sipërfaqe të përgjithshme 4480 m2, Zona Kadastrale Ferizaj, Komuna Ferizaj, e cila evidentohet në emrin e NSH "Pasuria Bujqësore" Ferizaj, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilit rekomandohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 353 m2, pjesë e parcelës nr. 292-1, me sipërfaqe të përgjithshme 4480 m2, Zona Kadastrale Ferizaj, Komuna Ferizaj, e cila evidentohet në emrin e NSH "Pasuria Bujqësore" Ferizaj, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Agencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska Agencija za Privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo
20 / 10 / 09 - Prishtinë - Priština

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/5

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet Inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 445m2, pjesë e parcelës kadastrale nr.292-5, Zona Kadastrale Ferizaj, pronë e NSH "Pasuria Bujqësore" me parashtruesit, nga cilësia e tyre si bashkëpronar me nga 1/2 (një/të/dytën) e pjesës ideale, që të dytë nga Ferizaji.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilit rekomandohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 445m2, pjesë e parcelës kadastrale nr.292-5, Zona Kadastrale Ferizaj, pronë e NSH "Pasuria Bujqësore" me parashtruesit, nga cilësia e tyre si bashkëpronar me nga 1/2 (një/të/dytën) e pjesës ideale, që

Raportet Rekomanduese i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-181/6

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 439 m2, pjesë e parcelës Kadastrale Nr. 292-5, me sipërfaqe te përgjithshme 4480 m2, ZK Ferizaj, pronë e NSH "Pasuria Bujqësore" me parashtruesin, nga Ferizaji.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilit rekomandohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 439 m2, pjesë e parcelës Kadastrale Nr. 292-5, me sipërfaqe te përgjithshme 4480 m2, ZK Ferizaj, pronë e NSH "Pasuria Bujqësore" me parashtruesin, nga Ferizaji.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/7

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullorja (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e vendeve të punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Shtyhet afati për hyrjen në fuqi të skemës së re organizative.**

II. **Skema e re organizative hyn në fuqi me datë 01 Tetor 2023.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 30 nëntor 2022 me vendimin BD 173-3 ka aprovuar Rregulloren nr. 07-2022 për Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 17 maj 2023, Bordi i Drejtorëve më anë të vendimit nr.ref. BD-180-1 ka dhënë pëlqimin për procedim të Rregullores së re për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKP për mendim këshillimor te Ministri përgjegjës për Administratë Publike, Ministri përgjegjës për Financa dhe Auditori i Përgjithshëm. Poashtu duke pas parasysh ankesat e punonjësve në ristrukturim që janë ende të pafinalizuara dhe duke pasur parasysh se me vendimin nr. BD-173/3 struktura e re organizative pritej të hyjë në fuqi me datë 01 qershor 2023, si dhe pas parasysh se nga momenti i përcjelljes së Rregullores për mendim këshillimor te Ministri përgjegjës për Administratë Publike, Ministri përgjegjës për Financa dhe Auditori i Përgjithshëm, afati për dhënie të pëlqimit është 15 ditë, u konsiderua e nevojshme që ky afat të shtyhet për katër (4) muaj pra deri me datë 01 tetor 2023.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-181/8**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/9

Në bazë të nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe në bazë të Rregullores 04/2022 e datës 31 gusht 2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet qiradhënia e asetit – antena e Telekomit të Kosovës e vendosur në Hotel Molika në Brezovicë, bazuar në listën e bashkangjitur për qiradhënie aset i NSH Brezovicë.**

I. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e raportit të vlerësimit për antenën e Telekomit të Kosovës të vendosur të NSH Brezovicë.

Me qëllim të përcaktimit të saktë të çmimit të tregut për asetin/antenën e Telekomit të Kosovës të vendosur në kulmin e Hotel Molika në Brezovicë, Bordi i Drejtoreve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2023 ka nxjerr vendimin numër BD-178/33 me të cilin vendim ka shqyrtuar ankesën e Telekomit të Kosovës dhe ka kërkuar që të bëhet ri vlerësim i qirasë për vlerën që duhet të paguaj Telekomi i Kosovës për antenën e vendosur të Hotel Molika në Brezovicë.
Komisioni i themeluar nga Drejtori Menaxhues ka bërë vlerësimin e qirasë për antenën e vendosur te Hotel Molika në Brezovicë bazuar në kontratën që ka të lidhur me një operator të ngjashëm Inex Sharr Planina në Brezovicë dhe karakteristikat teknike dhe tjera të antenave si dhe resurset e ndërmarrjes Inex Sharr Planina si rryma që shfrytëzohen nga Telekomi i Kosovës. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Lista e asetit të qirasë për NSh Inex Sharr Planina Brezovicë

Nr.	Regjioni	AKP ID	Emri i NSH-së	Përshkrimi i Asetit/Pronës	Sipërfaqja	Vendodhja e asetit/pronës	Qiramarrësi	Data e fillimit të qirasë	Data e përfundimit	Shuma mujore e Qirasë/Euro me tvsh	Pagesa në llogari të Ndërmarrjes	Koment
1	Gjilan	GJI092	Inex Sharr Planina Brezovicë	Antena te Hotel Molika	N/A	Brezovicë	Telekomi i Kosoves	01.12.2022	30.05.2024	525.00 €	NLB Banka	Propozim për qiradhënie

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/10

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; nenit 10, paragrafi 1.3 i Rregullores Nr. Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore si dhe nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të hapësirës afariste në kuadër të ndërtesës administrative në rr. Fehmi Agani (ATK-te qafa), me sipërfaqe totale prej 240 m² në pronësi të NSH Mekanizimi PRN098, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 1,552.00 bruto në muaj.**

II. **Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së dhe Autoriteti i Likuidimit që këtw aset ta vendosë në listë të aseteve për qiradhënie përmes tenderit publilk.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoritetit i Likuidimit dhe Menaxhmenti për qiradhënie direkte të hapësirës afariste në kuadër të ndërtesës administrative në rr. Fehmi Agani (ATK-te qafa), me sipërfaqe totale prej 240 m2 në pronësi të NSH Mekanizimi PRN098 sipas kwrkesws sw Galeria Ndërkombëtare për Artin Kontemporan "Lambdalambdalambda".

Bordi vlerësoi se shpallja publike për qiradhënie të këtij aseti duhet të bëhet në mënyrë më gjithëpërfshirëse ashtu që publiku të ketë qasje më të gjerë në informatat për tenderin. Në këtë mënyrë rritet konkurueshmëria dhe çmimet e ofruara për pronën shoqërore. Nëse shpallet tenderi për këtë aset, rritet konkurueshmëria dhe mund të arrihet çmim më i lartë që do mundësonte të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta. Ndërmarrja në fjalë do të jetë si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/11

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; nenit 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore ; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe nenit 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 40 m^2 të depos në Rr. "Hasan Prishtina" p.nr në Mitrovicë Jugore në pronësi të NSh "Obuca" Beograd, Njësia Mitrovicë MIT143, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 100.00 për një muaj.**

II. **Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së dhe Autoriteti i Likuidimit që këtë aset ta vendosë në listë të aseteve për qiradhënie përmes tenderit publilk.**

III. **Udhëzohet Autoriteti i Likuidimit që për periudhën e shfrytëzimit në mënyrë të paautorizuar, të paraqesë padi për kompensimin e dëmit në emër të qirasë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.**

IV. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoritetit i Likuidimit dhe Menaxhmenti për qiradhënie direkte të të sipërfaqes prej 40 m2 të depos në Rr. "Hasan Prishtina" p.nr në Mitrovicë Jugore në pronësi të NSh "Obuca" Beograd, Njësia Mitrovicë MIT143 sipas kërkesës së palës Vedat Vidishiqi.

Bordi vlerësoi se shpallja publike për qiradhënie të këtij aseti duhet të bëhet në mënyrë më gjithëpërfshirëse ashtu që publiku të ketë qasje më të gjerë në informatat për tenderin. Në këtë mënyrë rritet konkurueshmëria dhe çmimet e ofruara për pronën shoqërore. Nëse shpallet tenderi për këtë aset, rritet konkurueshmëria dhe mund të arrihet çmim më i lartë që do mundësonte të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta. Ndërmarrja në fjalë do të jetë si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO - Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska Agencija za Privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo - ZQ / EQ / QS - Prishtinë - Priština

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-181/12

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; nenit 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore ; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe nenit 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 52.20 m² të hapësirës afariste në katin e katërt (4), të ndërtesës administrative nr. dy (2), e ndërtuar mbi parcelat nr. 1413 dhe 1416 Zona Kadastrale Mitrovicë e Jugut në pronësi të NSh "Jugobanka" MIT101, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 190.00 për një muaj pwr kërkesën e OJQ "REC".**

II. **Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së dhe Autoriteti i Likuidimit që këtë aset ta vendosë në listë të aseteve për qiradhënie përmes tenderit publilk.**

III. **Udhëzohet Autoriteti i Likuidimit që për periudhën e shfrytëzimit në mënyrë të paautorizuar, të paraqesë padi për kompensimin e dëmit në emër të qirasë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.**

IV. **Agjencia nuk tërhiqet nga padia e parashtruar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me C.nr. 418/2013 ndaj të paditurëve, në mesin e të cilëve është edhe KK Mitrovicë – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me lejen e së cilës OJQ "REC" ka hyrë në shfrytëzim të hapësirave të lartë cekurave. Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit – AKP do të qëndrojë mbrapa pretendimeve të paraqitura në padi dhe do të kërkojë kompensimin për periudhën e shfrytëzimit të paligjshëm të kësaj hapësire objekt i kësaj kërkese nga viti 2011 deri më 31.12.2022, fillimisht nga ana e KK Mitrovicë – Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, mirëpo në ndërkohë do të ndërmarrë hapa ligjor për zgjerimin e padisë duke përfshirë si të paditur edhe OJQ "REC" me kërkesën e kompensimit të dëmit për shfrytëzimin e paligjshëm nga viti 2021 deri më 31.12.2022. Në rast se kërkesa për zgjerim të padisë refuzohet atëherë duhet të konsiderohet që barra për kompensim edhe për periudhën e shfrytëzimit nga ana e OJQ "REC" bie mbi KK Mitrovicë – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport sipas padisë C.nr. 418/2013.**

V. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoritetit i Likuidimit dhe Menaxhmenti për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 52.20 m2 të hapësirës afariste në katin e katërt (4), të ndërtesës administrative nr. dy (2), e ndërtuar mbi parcelat nr. 1413 dhe 1416 Zona Kadastrale Mitrovicë e Jugut në pronësi të NSh "Jugobanka" MIT101, sipas kërkesës së OJQ "REC".

Bordi vlerësoi se shpallja publike për qiradhënie të këtij aseti duhet të bëhet në mënyrë më gjithëpërfshirëse ashtu që publiku të ketë qasje më të gjerë në informatat për tenderin. Në këtë mënyrë rritet konkurueshmëria dhe çmimet e ofruara për pronën shoqërore. Nëse shpallet tenderi për këtë aset, rritet konkurueshmëria dhe

SD

mund të arrihet çmim më i lartë që do mundësonte të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta. Ndërmarrja në fjalë do të jetë si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - Agencia Kosovare e Privatizimit - ZQ / KQ / QS - Prishtinë - Priština - REPUBLIKA KOSOVA - Kosovska Agencija za Privatizaciju - Privatization Agency of Kosovo

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-181/13

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; nenit 10, paragrafi 1.5 dhe 1.3 i Rregullores Nr. Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore ; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe nenit 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 126.3 m^2 të hapësirës afariste në katin e katërt (4), të ndërtesës administrative nr. dy (2), e ndërtuar mbi parcelat nr. 1413 dhe 1416 Zona Kadastrale Mitrovicë e Jugut në pronësi të NSh "Jugobanka" MIT101, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 450.00 për një muaj për kërkesën e OJQ "Rinas".**

II. **Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së dhe Autoriteti i Likuidimit që këtë aset ta vendosë në listë të aseteve për qiradhënie përmes tenderit publilk.**

III. **Udhëzohet Autoriteti i Likuidimit që për periudhën e shfrytëzimit në mënyrë të paautorizuar, të paraqesë padi për kompensimin e dëmit në emër të qirasë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.**

IV. **Agjencia nuk tërhiqet tërheqje nga padia e parashtruar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me C.nr. 418/2013 ndaj të paditurëve, në mesin e të cilëve është edhe KK Mitrovicë – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me lejen e së cilës OJQ "RINAS" ka hyrë në shfrytëzim të hapësirave të lartë cekurave. Për më tepër, Autoriteti i Likuidimit – AKP do të qëndrojë mbrapa pretendimeve të paraqitura në padi dhe do të kërkojë kompensimin për periudhën e shfrytëzimit të paligjshëm të kësaj hapësire objekt i kësaj kërkese nga viti 2011 deri më 31.12.2022, fillimisht nga ana e KK Mitrovicë – Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, mirëpo në ndërkohë do të ndërmarrë hapa ligjor për zgjerimin e padisë duke përfshirë si të paditur edhe OJQ "RINAS" me kërkesën e kompensimit të dëmit për shfrytëzimin e paligjshëm nga viti 2019 deri më 31.12.2022. Në rast se kërkesa për zgjerim të padisë refuzohet atëherë duhet të konsiderohet që barra për kompensim edhe për periudhën e shfrytëzimit nga ana e OJQ "RINAS" bie mbi KK Mitrovicë – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.**

IV. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoritetit i Likuidimit dhe Menaxhmenti për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 126.3 m2 të hapësirës afariste në katin e katërt (4), të ndërtesës administrative nr. dy (2), e ndërtuar mbi parcelat nr. 1413 dhe 1416 Zona Kadastrale Mitrovicë e Jugut në pronësi të NSh "Jugobanka" MIT101, sipas kërkesës së OJQ "Rinas".

50

Bordi vlerësoi se shpallja publike për qiradhënie të këtij aseti duhet të bëhet në mënyrë më gjithëpërfshirëse ashtu që publiku të ketë qasje më të gjerë në informatat për tenderin. Në këtë mënyrë rritet konkurueshmëria dhe çmimet e ofruara për pronën shoqërore. Nëse shpallet tenderi për këtë aset, rritet konkurueshmëria dhe mund të arrihet çmim më i lartë që do mundësonte të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta. Ndërmarrja në fjalë do të jetë si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska Agencija za Privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo
ZQ / HQ / GS - Prishtinë - Priština
X

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/14

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, nenit 10, paragrafi 1.2 si dhe paragrafi 3 i Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore (Ndryshuar me Rregulloren nr. 02/2023 për amadamentimin e Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore), neni 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të hapësirave afariste në katin e pestë të ndërtesës administrative nr. 2 (e njohur më parë si ish Bankos), me sipërfaqe totale prej 188.1 m² në pronësi të NSh "Jugobanka" MIT101, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 300.00 Euro/muaj (bruto) për kërkesën nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) – Qendra për Trashëgimi Kulturore Mitrovicë.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoritetit i Likuidimit dhe Menaxhmenti për qiradhënie direkte të hapësirave afariste në katin e pestë të ndërtesës administrative nr. 2 (e njohur më parë si ish Bankos), me sipërfaqe totale prej 188.1 m2 në pronësi të NSh "Jugobanka" MIT101 sipas kërkesës nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) – Qendra për Trashëgimi Kulturore Mitrovicë.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Pasi që parashtrues i kërkesës është Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve konform nenit 10 par.3 të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore (*sipas Rregullores nr. 02/2023 për amadamentimin e Rregullores nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore*), çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. Në lidhje me këtë, më datë 23 maj 2023 është pranuar e-mail nga ana e Përfaqësuesit të MKRS-së, në të cilën kanë deklaruar se kanë të destinuar shumën prej 1,200.00 Euro në vit (bruto) apo 100 Euro në muaj. Arsyetimi i kërkesës nga ana e parashtruesit është që të akomodohet përkohësisht stafi i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore të Mitrovicës në hapësirat afariste të ish-Bankos pasi që ndërtesa e tyre do të rinovohet. Pasi që çmimi i propozuar nga ana e MKRS-së sipas AL-së ishte relativisht i ulët, në krahasim me qiratë tjera në hapësirat e njëjta afariste, sipas sugjerimit të AL, Bordi vendosi që ti ofrojë MKRS-së këtë hapësirë në sipërfaqe prej 188.1 m2 për një çmim të arsyeshëm prej afërsisht 300 €/muaj, e që paraqet qira më të ulët në më tepër se 50% të shumës në krahasim me qiratë tjera në hapësirat e njëjta afariste. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/15

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; nenit 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore ; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe nenit 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 23.5 m^2 të ish dyqanit të peshqeve në Mitrovicë në pronësi të NSh "KB Agrokultura" MIT002, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 180.00 për një muaj për kërkesën e palës N'Pikë Shop dhe Kujdestari sh.p.k.**

II. **Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së dhe Autoriteti i Likuidimit që këtë aset ta vendosë në listë të aseteve për qiradhënie përmes tenderit publilk.**

III. **Udhëzohet Autoriteti i Likuidimit që për periudhën e shfrytëzimit në mënyrë të paautorizuar, të paraqesë padi për kompensimin e dëmit në emër të qirasë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoritetit i Likuidimit dhe Menaxhmenti për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 23.5 m2 të ish dyqanit të peshqeve në Mitrovicë në pronësi të NSh "KB Agrokultura" MIT002 sipas kërkesës së palës N'Pikë Shop dhe Kujdestari sh.p.k.

Bordi vlerësoi se shpallja publike për qiradhënie të këtij aseti duhet të bëhet në mënyrë më gjithëpërfshirëse ashtu që publiku të ketë qasje më të gjerë në informatat për tenderin. Në këtë mënyrë rritet konkurueshmëria dhe çmimet e ofruara për pronën shoqërore. Nëse shpallet tenderi për këtë aset, rritet konkurueshmëria dhe mund të arrihet çmim më i lartë që do mundësonte të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta. Ndërmarrja në fjalë do të jetë si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë. Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-181/16

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh KB Agromorava (në likuidim) GJI035, nga Rajoni i Gjilanit.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët NSh KB Agromorava (në likuidim) GJI035.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të NSh KB Agromorava (në likuidim) GJI035.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA
Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska Agencija za Privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo
ZQ / HQ / GS - Prishtinë - Priština

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-181/17

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përfundimtare të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh KB Drelaj (në likuidim) PEJ045, nga Rajoni i Pejës.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët NSh KB Drelaj (në likuidim) PEJ045.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të NSh KB Drelaj (në likuidim) PEJ045.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-181/18

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 4/2020 për politikat dhe procedurat e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NSh "Lux" MIT039 (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 17,200.00 dhe atë për vijën buxhetore si në vijim:

1.	**e17 (Ofruesit e shërbimeve (Pagesa Bruto) në vlerë prej**	**€ 200.00**
2.	**e18 (Ofruesit e shërbimeve (Pagesa Neto) në vlerë prej**	**€ 8,000.00**
3.	**e24 (Udhëtime Zyrtare) në vlerë prej**	**€ 5,000.00**
4.	**e38 (Tatimi ne te ardhurat personale te OSH) në vlerë prej**	**€ 4,000.00**

II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.

I. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh MIT039 LUX (në likuidim).

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për Ofruesit e shërbimeve (Pagesa Bruto), Ofruesit e shërbimeve (Pagesa Neto), Udhëtime Zyrtare, Tatimi ne te ardhurat personale te OSH, në vlerë prej € 17,200.00 pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NSh "Lux" MIT039.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/19

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 4/2020 për politikat dhe procedurat e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NSh PRN006 Shpezëtaria & Peshkataria (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej €18,500.00 dhe atë për vijën buxhetore si në vijim:**
   1. **e19 (Tatimi i të ardhurave personale për Ofruesit e Shërbimeve) në vlerë prej € 1,000.00**
   2. **e22 (Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve) në vlerë prej € 17,500.00**

II. **Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh PRN006 Shpezëtaria & Peshkataria .

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për Tatimin e të ardhurave personale për Ofruesit e Shërbimeve dhe Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve, në vlerë prej €18,500.00 pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NSh PRN006 Shpezëtaria & Peshkataria .

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023

REPUBLIKA E KOSOVËS - Agjencia Kosovare e Privatizimit - ZQ / HQ / GS - Prishtinë - Prishtina - REPUBLIKA KOSOVA - Kosovska Agencija za Privatizaciju - REPUBLIC OF KOSOVO - Privatisation Agency of Kosovo

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/20

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në; nenit 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore ; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, si dhe nenit 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 200 m2 të depos në ZK Babush i Muhaxherëve, Lipjan në pronësi të NSh "Fabrika e Duhanit" MIT049, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 110.00 për një muaj për kërkesën e NTSH Albina përfaqësuar nga Shyqëri Jashari.**

II. **Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së dhe Autoriteti i Likuidimit që këtë aset ta vendosë në listë të aseteve për qiradhënie përmes tenderit publilk.**

III. **Udhëzohet Autoriteti i Likuidimit që për periudhën e shfrytëzimit në mënyrë të paautorizuar, të paraqesë padi për kompensimin e dëmit në emër të qirasë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoritetit i Likuidimit dhe Menaxhmenti për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 200 m2 të depos në ZK Babush i Muhaxherëve, Lipjan në pronësi të NSh "Fabrika e Duhanit" MIT049 sipas kërkesës së palës NTSH Albina përfaqësuar nga Shyqëri Jashari.

Bordi vlerësoi se shpallja publike për qiradhënie të këtij aseti duhet të bëhet në mënyrë më gjithëpërfshirëse ashtu që publiku të ketë qasje më të gjerë në informatat për tenderin. Në këtë mënyrë rritet konkurueshmëria dhe çmimet e ofruara për pronën shoqërore. Nëse shpallet tenderi për këtë aset, rritet konkurueshmëria dhe mund të arrihet çmim më i lartë që do mundësonte të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta. Ndërmarrja në fjalë do të jetë si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS – Agencia Kosovare e Privatizimit – ZB / NQ / 06 – Prishtinë – Prishtina – REPUBLIC OF KOSOVO – PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO – PAK

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-181/21

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 maj 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Jepet pëlqimi Komunës se Ferizajt për kryerjen e punimeve rregullimin e segmenteve rrugore (bypass-ve) të përkohshëm të cilat kalojnë përmes parcelave: 00528-0, 00527-0, 03135-1, 03135-2, 03135-3, 00518-0, 00520-0, 00544-0, 00536-0 dhe 00542-0 të NSh Plantacioni i Pemëve.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës së Komunës së Ferizajt për dhënien e pëlqimit për kryerjen e punimeve, rregullimin e segmenteve rrugore (bypass-ve) të përkohshëm të cilat kalojnë përmes parcelave: 00528-0, 00527-0, 03135-1, 03135-2, 03135-3, 00518-0, 00520-0, 00544-0, 00536-0 dhe 00542-0 të NSh Plantacioni i Pemëve.

Arsye e marrjes së këtij vendimi është se Komuna e Ferizajt, përkatësisht Drejtoria e Infrastrukturës, në vazhdën e implementimit të projekteve transformuese të infrastrukturës rrugore, ka filluar ndërtimin e nënkalimit për vetura dhe këmbësore në afërsi të Stacionit Policor në Ferizaj, pasi që kjo zonë për shkak të punimeve duhet të jetë tërësisht jashtë funksionit, pra nuk mund të këtë qarkullim për vetura gjë që do të shkaktonte bllokim tërësor të qarkullimit për mijëra banor ngaqë paraqet zonë me frekuentim jashtëzakonisht të lartë urban dhe ndër-urban si p.sh. me komunat Shtime, Suharekë dhe Prizren. Për të evituar këtë bllokim të komunikacionit nga Komuna e Ferizajt kemi pranuar kërkesën për lejimin e ndërtimit të segmenteve rrugore (bypass) të përkohshme në pronat të menaxhuara nga AKP. Gjithashtu në këtë kërkesë Komuna e Ferizajt thekson që merr përsipër të gjitha shpenzimet për ndërtimin e këtyre segmenteve rrugore (bypass) dhe kthimin në gjendje të mëparshme, pa dëmtuar apo zhvlerësuar pronën e NSh Plantacioni i Pemëve e cila është nën menaxhimin e AKP-së, duke sqaruar që aktualisht në këto prona nuk ka të ndërtuar asgjë dhe nuk zhvillohet kurrfarë veprimtarie nga persona fizik apo juridik.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 maj 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA
Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska Agencija za Privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo
ZQ / HQ / GS - Prishtinë - Pristina

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës